



Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 pika (c) të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, nenin 29 dhe 54 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 45 paragrafi 4, lidhur me nenin 46 paragrafi 2, të Ligjit Nr-03/L-048, për menaxhimin e financave publike të përgjithshme, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 27/2008”, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, 30.03.2021 miratoi këtë;

V E N D I M

Për miratimin e llogarisë përfundimtare të të ardhurave dhe të shpenzimeve të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën **Janar–Dhjetor 2020**.

Neni 1

Me këtë vendim miratohet llogaria përfundimtare e Komunës së Suharekës për periudhën **Janar – Dhjetor të vitit 2020**, i cila përmban të dhënat si më poshtë:

Nr.Rd	Mjetet e Komunës	Realizimi 2020	Përqindja
1	Të ardhurat e gjithëmbarshme	17,799,491.72	100.00%
2	Të dalurat e gjithëmbarshme	16,680,087.27	93.71%
3	Teprica e të hyrave ndaj të dalurave	(1,119,404.45)	-6.29%
a	Teprica e të hyrave ndaj të dalurave B.R.K	319,925.51	1.80%
b	Teprica e Financimeve nga huamarrjet	21,704.95	0.12%
c	Teprica nga donacionet	2,860.57	0.02%
d	Teprica e të hyrave ndaj të dalurave Mjet.vetanake 2020	613,658.28	3.45%
e	Tepric e të hyrave ndaj të dalurave Mjet.vetanake 2019	161,255.14	0.91%
	Teprica për bartje në vitin 2021	774,913.42	100.00%

Neni 2

Të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara si dhe teprica e të ardhurave në raport me shpenzimet e administruara të përcaktuara si në nenin 1 të këtij vendimi, janë shpalosur në bilancin e mjeteve të Komunës së Suharekës për periudhën **Janar–Dhjetor** të vitit 2020 dhe raporti si i tillë është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

Realizimi dhe zbatimi i këtij vendimi do të bëhet në pajtim me dispozita e Ligjeve në fuqi dhe Rregulloren e procedurës së përgjithshme për menaxhimin financiar të komunës së Suharekës.

Neni 4

Për zbatimin-implementimin e këtij vendimi kujdeset qeveria lokale e Komunës së Suharekës.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, kjo Rregullore hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr.03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 016-20156
Me datë 30.03.2021



Kryesuesi Kuvendit

Mr. ec Bexhet KUÇI